REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

C.nr.417/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore, e përbërë nga gjyqtari individual Naim Meholli, në çështjen juridike të paditësit BKS me seli në .... Rr. Fazli ...., kundër të padituritt N.A nga Komuna e ....- ....., baza e kontestit Rimbursim dëmi, pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit kryesor, me datë 21.09.2018 nxjerr këtë:

A K T GJ Y K I M

I. **REFUZOHET** padia dhe kërkesëpadia e paditëses BKS, kundër të padituritt N.A nga Komuna e ... me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta obligoj të padituritt që në emër të rimbursimit të dëmit, t'ia rimbursoj paditëses shumën prej 315 € dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim te caktuar duke llogaritur nga dita e ngritjes se padis e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet gjyqësore në afat 15 ditor pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit te detyrueshëm, **në tërësi si e pa bazuar**.

II. Secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësja ka ngritur padi në gjykatë me date 21.07.2017, me anë të së cilës ka kërkuar qe në emër të rimbursimit të demit, I padituri t'ia kompensoj shumën prej 315€ të shkaktuar në aksidentin e datës 28.12.2012.

I autorizuari i paditëses në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbesim në tërësi pran padis dhe kërkesëpadisë, nga shkresat e lendes rezulton se i padituri ne ditën e aksidentit përveç se nuk kishte leje siguruese te automjetit me veprimin e tij duke mos e mbajtur distancën e sigurisë ne mes te automjeteve e godet veturën B me ç 'rast shkakton dëme materiale ne automjetin B, duke e pasur parasysh se pala e dëmtuar kishe polis KASKO pranë "...." i dëmtuari paraqet kërkesë për kompensim demi dhe mbi këtë baze KS .... i'a kompenson demin palës se dëmtuar prej 315 euro dhe pas kompensimit paraqet kërkesë pranë tani paditëses qe te rimbursoj demin ne baze te dispozitave te LDM-se dhe LSD-se, tani paditësja pas vlerësimit te bazës juridike dhe

lartësisë se saj, komisioni për vlerësimin e dëmeve ja njeh bazën juridike dhe lartësinë e saj për rimbursimin e mjeteve. Duke u gjendur ne këtë situate tani ne këtë procedure te rimbursimit tani paditësja kërkon nga i padituri rimbursimin e demit ne vlerën e theksuar si ne padi, njëherësh shprehim gatishmëri qe këtë çështje ta mbyllim me pajtim Gjyqësor duke ja mundësuar rimbursimin e demit me këste mujore, duke hequr dore nga kamata ndëshkuese dhe shpenzimet e procedurës. Ka shtuar se sa i përket pretendimeve te te paditurit për vjetërsim te kësaj çështje nuk qëndrojnë ngase nga shkresat e lendes mund te shihet urdhëri për pagesë është i lëshuar me date 02.07.2014, për me shume vete dispozitate e LMD-se afatet e parashkrimit fillojnë te rrjedhin nga viti i ardhshëm kalendarik, andaj ne këtë kontest nuk kemi parashkrim.

Ne fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se nga provat e administruara konsiderojmë se u vërtetua baza juridike dhe lartësia e saj, andaj me rastin e vendosjes propozojmë qe kërkesëpadia te aprovohet ne tersi si e bazuar me kamatë ligjore sipas mjete te deponuara ne banka afariste mbi 1 vit pa destinim te caktuar si dhe shpenzimet e procedurës dhe atë ne emër te taksës gjyqësore për padi.

I padituri në seancë e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshtoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, siç shihet nga shkresat e lendes kemi vjetërsim te lendes sa i përket demit material, ka shtuar se ne rastin konkret nuk ka pasur ndonjë dem material dhe nuk e ndjej veten fajtor i propozoj gjykatës qe ta refuzoje kërkesëpadinë për shkak te vjetërsimit te lendes, shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

Gjykata në shqyrtimin kryesor i administroj këto prova: Dosja e demit nga BKS nr.742/2014, transferi i lëshuar nga BKS i datës 15.07.2014, urdhertransferi i datës 02.07.2014, ujdia jashtëgjyqësore e datës 30.06.2014, e-maili i datës 30.06.2014, vendimi nga departamenti i dëmeve I BKS-se i datës 20.03.2014, vendimi i shkalles se pare i datës 07.04.2014, raporti i aksidentit 2012-DR-757 i datës 28.12.2012, aktvlersimi i demit nga BKS i datës 16.06.2014, raportimi i demit nga i dëmtuari për punëdhënësin i datës 28.12.2012, raporti nga policia e Kosovës i datës 28.12.2012, certifikatë e regjistrimit te automjetit, raporti i aksidentit te komunikacionit i datës 29.12.2012, raporti i policisë njësia e hetimeve rajonale për komunikacion ne ...., 8 fotografi nga vend-ndodhja e aksidentit, kërkesa për rimbursimin e mjeteve nga Kompania e Sigurimeve .... për .... i datës 13.05.2014, vlerësimi i demit nga kompania e sigurimeve ... i datës 16.01.2013, fatura e autoservisit "...." i datës 06.02.2013, fatura nga autoservisi "...." për rregullimin e automjeteve i datës 15.03.2013, 3 fotografi nga automjeti i dëmtuar, konfirmimi i sigurimit i datës 27.08.2011, konfirmimi i sigurimit i datës 11.02.2013.

Pas shiqimit dhe analizimit te prova një nga një dhe të gjitha së bashku ashtu siç është përcaktuar me nenin 8 të LPK-së, gjykata vlerësoj se në mes palëve ndërgjyqëse nuk janë kontestuese këto fakte:

Nuk është kontestues fakti se i padituri ka qenë pjesëmarrës dhe shkaktar i aksidentit të datës 28.12.2012, pasi kjo vërtetohet në bazë të raportit të aksidentit.

Nuk është kontestues fakti se i padituri në momentin e aksidentit ka drejtuar automjetin "VW", me nr. të targave 03-129 BQ, i cili automjet ka qenë i pasiguruar gjegjësisht sigurimi i ka skaduar, ndërsa në të cilin aksident i padituri e ka goditur automjetin "...." pronë e EULEX.

Se personi i tretë EULEX nga aksidenti në fjalë ka pësuar, duke i shkaktuar dëme material, kjo vërtetohet me raportin e aksidentit me nr.2012-DR-757 i dt: 28.12.2012, nga skica e aksidentit, nga aktvlersimi i demit nga KS "ILLYRIA" i datës 16.01.2013, nga aktvlersimi i demit nga "BKS" i datës 16.06.2014.

Nuk është kontestues fakti se i padituri ka qenë shkaktar kryesor dhe i vetëm i aksidentit, kjo vërtetohet me raportin e aksidentit me nr.2012-DR-757 i dt. 28.12.2012, si dhe nga foto dokumentacioni qe gjendet ne shkresat e lendes.

Nuk është kontestues fakti se automjeti I personi te tretë "EULEX" për shkak të dëmtimeve materiale të pësuara është kompensuar fillimisht nga KS "...." ku vërtetohet nga konfirmimi bankar i pagesës se shumes 315 euro datës 15.03.2013.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se pas kompensimit te demit personit te tret nga KS "....", e njëjta ka parashtruar kërkesë për rimbursim te mjeteve nga BKS, kjo vërtetohet nga kërkesa e dt.13.05.2014.

Nga ujdia jashtëgjyqësore e lidhur me datën 30.06.2014 ne mes te BKS Dhe KS "...." si dhe urdhër transferi i BKS datës: 02.07.2014 vërtetohet fakti se KS "...." I është kryer pagesa në emër të rimbursimit të dëmit material të shkaktuara me lëshimet apo fajin e të padituri dhe atë në shumë prej 315 euro.

I padituri në deklarimin e tij në seancë ka deklaruar se e kundërshtoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, siç shihet nga shkresat e lendes kemi vjetërsim te lendes sa i përket demit material, i ka propozuar gjykatës qe ta refuzoje kërkesëpadinë për shkak te vjetërsimit te lendes.

Gjykata duke u bazuar ne pretendimet e te padituri për parashkrim te kërkesës, vërtetoi faktin se paditësja padinë e ka përpiluar me datën 21.07.2017, dhe te njëjtën e ka dërguar ne te njëjtën date ne post, drejtuar gjykatës kjo vërtetohet nga vula e pranimit te postes, ndërsa demin paditësja palës se tret i'a ka kompensuar me datën 02.07.2014, pra ne rastin konkret paditësja ka ushtruar padi 3 vite e 19 dite pas kompensimit te demit palës se dëmtuar.

Në raport me provat tjera të njëjta vetëm se vërtetojnë gjendjen faktike të arsyetuar nga gjykata me prova kryesore dhe tjerat janë të karakterit dytësorë.

Në rastin konkret afati për parashtrimin e padisë është 3 vjeçar konform nenit 357 të LMD-së citoi: "Kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhen në afat prej 3 viteve nga data kur i dëmtuari ka marr në dijeni për dëmin dhe për personin te cilin e ka shkaktuar dëmin". Në rastin konkret paditësja nga data 02.07.2014 ka pasur njohur për dëmin, dëmtuesin, llojin e demit, lartasin e tij, sepse ne atë kohe është bartë pagesa dhe rrjedhimisht është zvogëluar pasuria e paditëses, ndërsa po ashtu edhe para kësaj date ka pasur njohur për shkaktarin e dëmit, andaj padia ka mundur të paraqitet me se largu deri me datë: 02.07.2017. Pra ne rastin konkret paraqitja e padis nga ana e paditësit është 19 dite me vonës.

Afati për paraqitjen e padisë në rastin konkret është afat prekluziv ligjor i cili afat nuk ka mundësi të shtyhet pasi është afat ligjor.

Gjykata, lidhur me shpenzimet procedurale, u bazua në nenin 452 par 1 të LPK-së, mirëpo meqenëse pala e paditur nuk ka bërë shpenzime, shpenzimet e krijuara nga pala paditëse mbesin në barrë të saj.

Andaj nga të lartcekurat, e në bazë të nenit 143 par 3 të LPK-së(Ligjit të Procedurës Kontestimore), u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.417/2017. dt.21.09.2018

G J Y Q T A R I
Naim Meholli

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, ne afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përms kësaj gjykate.